

Karta e-përgjithëshme e apostollit Jakov.

Krye 1.

- 1 Jakovi, shërbëtuar i Perëndisë edhe i Zotit Jisu Krisht, mbë të dy-mbë-dhjetë faratë që janë përndarë andej e këtej, gëzuashi.
- 2 Numëro-e-ni për gëzim të-math, o vëllezërit' e mi, kur bini mbë çdo farë ngasjesh;
- 3 Dyke diturë, se provimi i besësë s'uaj
- 4 punon durim; Edhe durimi letë ketë punë të-sosurë, që të jeni të-sosur' edhe te-tërë, pa qënë të-metë as mbë ndonjë gjë.
- 5 Edhe ndë ndonjë prej jush është i-metë ndë dituri, letë lypënjë prej Perëndisë që u ep të-gjithëve pa kursim, e nukë qërton; edhe
- 6 dot' i epet' ati. Po letë lypënjë me besë, pa pasurë dyshim asfare; sepse ay që ka dyshim i gjan valës' së detit, që ngrihetë prej
- 7 erës' e përpiketë. Sepse letë mos pandehnjë
- 8 ay njeri, se dotë marrë gjë nga Zoti; Njeriu me dy mëndje është i-paqëndruarshim mbë gjith' udhët' e tia.
- 9 Edhe letë mburretë vëllaj shkallë-poshtërë

- 10 ndë të-lartët të ti; E i-pasuri ndë të-përunjurit të ti: sepse posi lule bari dotë shko-
- 11 një. Sepse lindi djelli me të-përvëluarët' e ti, edhë thau barinë, edhe lulej' e ati ra, edhe bukuria e faqes' s' ati humbi; kështu edhe i-pasuri dotë fyshketë ndë udhët të tia.
- 12 Lum ay njeri që duron ngasje; sepse passi të provonetë, dotë marrë kurorën' e jetësë, të-cilënë u është zotuarë Zoti atyreve që e duanë.
- 13 Asndonjë, kur ngitetë, letë mos thotë, se ngitem nga' Perëndia; sepse Perëndia nukë munt të ngitetë nga të-ligatë, edhe ay as-
- 14 ndonjë nukë nget. Pogjithësicili ngitetë dyke uhequr' e dyke ukobuarë prej dëshërimit të
- 15 vetëhes' së ti. Pastaj dëshërimi, si të mbarsetë, pjell faj; edhe faji, si të bënë, pjell vdekje.
- 16 Mos ugënjëni, o vëllezërit' e mi të-dashurë; Çdo dhënëje e-mirë, edhe çdo dhurëti e-sosurë, është së-sipërmi, edhe sbret nga
- 17 Ati i dritavet, mbë të-cilinë s' ka të-ndë-
- 18 rruarë a hie të kthyeri. Prej dashurimit të ti na polli me anë të fjalës' së të-vërtetësë, që të jemi neve një pem' e-parë e ndërtesavet t'ati.
- 19 Përandaj, o vëllezërit' e mi të-dashurë, çdo njeri letë jet' i-çpejtë mbë të dëgjuarë, i-mënuarë mbë të-folurë, i-mënuarë mbë zë-
- 20 mërim; Sepse zëmërimi i njeriut nukë pu-

- 21 non drejtërin' e Perendisë. Përandaj, si të hitni tej çdo ndyrësi e të-tepëruarë ligësie, pritni me butësi të fjalënë që është mbjellë ndër ju, e-cila munt të shpëtonjë shpirtëratë
- 22 t'uaj. Edhe bëni asish që e bënë fjalënë e jo vetëm' asish që e dëgjonjënë, dyke që-
- 23 njerë vetëhenë t'uaj. Sepse kush dëgjon fjalënë e nuk' e bën, ky i gjan një njeriu që shikon faqen' e ti naturale ndë pasqyrë;
- 24 Sepse e shikoj vetëhen' e ti, edhe iku, edhe
- 25 përnjëhere harroj i-çfarëtë ishte. Po ay që unjet' e shikon ndë nomt të-sosurë të lirisë, edhe qëndron mb' atë, ky dyke ubërë jo asi që dëgjon e harron, po asi që bën punënë, ky dotë jet' i-lumurë ndë punët të ti.
- 26 Nde pandeh ndonjë ndër ju se është i-feshim, edhe s'i vë fre gjuhës' së ti, po kōbon zëmërën' e ti, feja e këti është e-kotë.
- 27 Fe e-kthjellë' edhe e-papëgërë përpara Pë-rëndisë edhe Atit është këjo, Të shikonjë njeriu të-varfër' e gra të-va ndë shtrëngimt t'atyre, edhe të ruanjë vetëhen' e ti të-pazhy-erë nga bota.

Krye 2.

- 1 Vëllezërit' e mi, mos kini besën' e të-lav-duruarshimit Zotit t'ënë Jisu Krisht me të-2 bërë faqe. Sepse ndë hyftë ndë mbledhjet t'uaj ndonjë njeri që ka unazë t'artë me rrobë të-çkëlqyerë, edhe të hynjë edhe një

- 3 i-vobek me rrobë të-fëlliqurë, Edhe të shtini sytë mb' atë që ka veshurë rrobën' e-çkëlqyerë, edhe t'i thoni ati, Ti rri këtu mirë, edhe të vobegut t'i thoni, Ti rri atje, a, Rri
- 4 këtu ndënë ndënëkëmbjenë t'ime; A nukë bëtë me vetëhenë t'uaj të-çquarë ndër mest t'atyre, edhe ubëtë gjykatës inendimeve të-
- 5 liq? Pa dëgjoni, o vëllezërit' e mi të-dashurë, A nukë sgjodhi Perëndia të-vobeqt' e kësaj bote për të-pasurë ndë besët, edhe për trashëgimtarë të mbretërisë, të-cilën' u është
- 6 zotuarë atyreve që e duanë? Po ju e çpënderuatë të-vobegunë. A nuk' u mundonjënë juve të-pasuritë, edhe ata u heqnjënë ndë-
- 7 për gjykatat? A nukë shanjënë atë emërin'
- 8 e-mirë, me të-cilinë jeni quajturë? Ndë ruani pra nomin' e-mbretëruarë, pas shkronjësë, „Të duash të-afërminë t' ënt posi ve-
- 9 tëhenë t'ënde,“ bëni mirë; Po ndë mbani anë, bëni faj, edhe qërtohi nga nomi si porosi-shkelës.
- 10 Sepse ay që të ruanjë gjithë nominë, edhe të fëjenjë mbë një gjë, është fajtuar mbë të-
- 11 gjitha. Sepse ay që tha, „Mos kurvëronjç,“ tha edhe, „Mos vraç“. Po ndë mos kurvë-rofsh, po të vraç, ubëre shkelës i nomit.
- 12 Kështu flisni, edhe kështu bëni, sikurse jeni për të gjykuarë prej nomit të lirisë;
- 13 Sepse gjyqi dotë jetë i-papërdëllyershim mb' atë që s' bëri përdëllim; edhe përdëlli-

- mi mburretë kundrë gjyqit.
- 14 Ç' dobi ka, o vëllezërit' e mi, ndë thëntë ndonjë se ka besë, e punëra të mos ketë?
- 15 mos munt t'a shpëtonjë besa? Ndë qoftë se vëllaj a motëra janë lakuriq, edhe u shteret'
- 16 ushqimi i-përditshim, Edhe t'u thot' atyre ndonjë prej jush, Shkoni ndë paqtim, ngrohi e ngihi, e të mos u epni atyreve atoqë janë
- 17 të-nevojshime për trupinë, ç'dobi ka? Kështu edhe besa, ndë mos pastë punëra, është
- 18 e-vdekurë ndë vetëhet të saj. Po dotë thotë ndonjë, Ti ke besë, e unë kam punëra; dëfte-më besënë t'ënde nga punërat' e tua, edhe unë dotë të dëftenj besënë t'ime nga
- 19 punërat' e mia. Ti beson se Perëndia është një; mirë bën; edhe djajtë besonjënë, edhe
- 20 dridhenë. Po a do të kupëtonjç, o njeri i-kotë, se besa pa punëratë është' e-vdekurë?
- 21 Avraami, ati ynë, a nukë dolli i-drejtë nga punëratë, kur pruri Isaakunë, të birin' e ti,
- 22 mbi thorenë? A sheh se besa punonte bashkë me punërat' e ati, edhe besa ubë
- 23 e-sosurë nga punëratë? Edhe umbush shkronja që thotë, „Edhe Avraami i besoj Pe-rëndisë, edhe i unumërua për drejtëri“ edhe
- 24 uquajt „miku i Perëndisë“. A shihni pra se njeriu del i-drejtë nga punëratë, e jo nga
- 25 besa vetëmë? Edhe gjithashtu edhe kurva Rahabë a nukë dolli e-drejtë nga punëratë, kur priti ata që ishinë dërguarë, edhe i nxrori

26 nga një tjetërë udhë? Sepse sikundrë trupi pa frymë është' i-vdekurë, kështu edhe besa pa punëratë është' e-vdekurë.

Krye 3.

- 1 Mos bëhi shumë mësonjës, o vëllezërit' e mi, dyke diturë se dotë marrëmë më të-math
- 2 dënim; Sepse mbë shumë *punëra* të-gjithë fëjejmë. Ndë qoftë se nukë fëjen ndonjë ndë fjalë, ky ështëë burr' i-sosurë, i-fuqishim
- 3 t'i vërë fre edhe gjithë trupit. — Na kuajvet frenjtë u'a vëmë ndë gojë, që të na bindenë, edhe e heqmë gjithë trupin' e atyreve. —
- 4 Na edhe aniatë, ndonëse janë kaqë të-mëdha edhe shtyhenë prej erërash të-forta, shpihenë prej një timoni të-vogëlë, atje ku të dojë
- 5 qivernitari. Kështu edhe gjuha ështëë një cop' e-vogëlë, po mbahetë mbë të math. — Na pak zjarr tek djek kaqë të-madhe lëndë.
- 6 Edhe gjuha ështëë zjarr, bota e shtrëmbërisë. Kështu ndër anët të *trupit* t'ënë gjuha ështëë ajo që fëlliq gjithë trupinë, edhe flakëron' rrotën' e jetësë, edhe flakëronetë prej gjehe-nësë.—Sepse çdo farë bishash e shpesësh, shtërpinjsh e gjësh të-gjalla të detit, sbutetë, edhe ështëë sbuturë prej naturës' së njeriut;
- 8 Po gjuhën' asndonjë nga njerëzitë s'munt t'a sbutnjë; ështëë një e-keqe që s'munt të push-
- 9 tonetë, plot me vërer që bje vdekje. Me atë bekojmë Perëndinë edhe Atinë, edhe me atë

- mallëkojmë njerëzitë që janë bërë pas shëm-
 10 bëllimit të Perëndisë. Prej gjithasaj goje del
 bekim edhe mallëkim. Nukë duhetë, o vëlle-
 11 zërit' e mi, të bënenë këto kështu. Mos bu-
 rimi prej gjithasaj vëre buron ujë t'ëmbëlë
 12 edhe të-hidhurë? Mos munt, o vëllezërit' e mi,
 drur' i fikut të bënjë ullinj, a hërdhia të bë-
 një fiq? Kështu asdonjë burim s' munt të bë-
 një ujë të-kripurë edhe t'ëmbëlë.
 13 Kush është ndër ju i-mëncim e i-diturë?
 letë rrëfenjë prej të-sjellavet të-mira punë-
 14 rat' e ti me butësi të urtësie. Po ndë kini ndë
 zëmëret' t'uaj cmir të-hidhurë edhe grindje,
 mos mbahi mbë të-math edhe mos gënjëni
 15 kundrë së-vërtetësë. Këjo dituri nukë sbret
 prej së-sipërmi, po është prej dheu, prej
 16 shtëze, prej djalli; Sepse ku ka cmir e
 grindje, atje ka trazyrë e çdo punë të-ligë.
 17 Po dituria që është prej së-sipërmi, më për-
 para është e-kthjellëtë, pastaj paqtore, e-
 butë, e-bindurë, plot me përdëllim e me pu-
 nëra të-mira, s'mbanj anë edhe s'është me
 18 dy faqe. Edhe pema e drejtërisë mbilletë
 me paqtim prej atyreve që bënjënë paqtim.

Krye 4.

- 1 Nga se vinjënë luftëra e qarta ndër ju?
 Jo që këtej, nga dëshërimetë që luftonjënë
 2 ndër anët të trupit t'uaj? Dëshëroni, e nukë
 keni; vritni e keni cmir, edhe nukë munt të

- qëlloni; zihi e luftoni, po nukë keni; sepse
 3 nukë lypni. Lypni, e nukë merrni, sepse lyp-
 ni keq, që të prishni ndë dëshërimet t'uaj.
 4 O kurvarë e kurva, nukë dini se miqësia
 e botësë është armiqësi e Perëndisë? ay pra
 që të dojë të jetë miku i botësë, bënetë ar-
 5 miku i Perëndisë. Apo pandehni se mbë kot
 shkronja thotë, Për cmir dëshëron fryma që
 6 ndënji ndër ne? Po Perëndia ep një hir më
 të-math, përandaj thotë, „Perëndia madhë-
 shtorëvet u rri kundrë, po kryeunjurëvet u ep
 7 hir.“ Binduni pra te Perëndia; rri kundrë
 8 djallit, edhe dotë ikënjë nga ju. Afërohuni
 Perëndisë, edhe dot' u afëronetë juve. Pa-
 stroni duartë t'uaj, o fajtorë, edhe qëroni zë-
 9 mëratë, o njerës me dy mëndje. Hiqni keq
 e bëni vajë e qani; të-qeshuritë t'uaj letë
 kthenetë mbë vajë, edhe gëzimi juaj mbë
 10 hidhërim. Përunjuni përpara Zotit, edhe dot'
 u ngrerë lart juve.
 11 Mos flisni keq njëri për tjetërinë, o vë-
 llezër; ay që flet keq për vëllanë, edhe gjy-
 kon të vëllanë, flet keq për nomnë, edhe
 gjykon nomnë; edhe ndë gjykon nomnë, nu-
 12 kë je ruajtës i nomit, po gjykatës i atit. Një
 është nom-dhënësi që munt të shpëtonjë e-
 dhe të humbasë; cili je ti që gjykon tjetë-
 rinë?
 13 Ejani tashti ju që thoni, Sot a nesërë dotë
 vemi ndë këtë qytet, edhe dotë bëjmë atje

- një vit, edhe dotë tregëtojmë e dotë fitojmë;
- 14 Ju që nukë dini se ç' dotë bënetë nesërë; sepse ç' është jeta juaj? është me të-vërtetë një avull që duketë për pakëzë *kohë*, e pastaj humbetë; Ndë vëntt që të thoni, Ndë dashtë Perëndia, edhe ndë rrofshimë, dotë
- 16 bëjmë këtë a atë. Po tashti mburreni mbë madhështirat t' uaj; çdo të-tillë të-mburrurë është të-lik.
- 17 Mb' atë pra që di të bënë të-mirë, edhe nukë bën, mb' atë *kjo* është faj.

Krye 5.

- 1 Ejani tashi' ju të-pasuritë, qani e ulurini për
- 2 të-këqiatë që dotë vinjënë mbi ju. Pasja juaj ukalp, edhe rrobatë t' uaj u'a brëjti mola.
- 3 Ari juaj edhe ergjëndi undryshk, edhe ndryshku i atyreve dotë jetë për dëshmim kundrë jush, edhe dotë hajë mishratë t' uaj si zjarr; mblohtë thesarë për ditt' e-pastajme.
- 4 Na tek bërtet paga që u'a keni mbajturë punëtorëvet që korrnë aratë t' uaj; edhe të-bërtiturat' e korrësvet hynë ndë veshët të
- 5 Zotit Sabaoth. Ukënaqtë e bëtë pallë mbi dhet; ushqyetë zëmëratë t' uaj posi mbë ditë
- 6 të të-theruri; Dënuatë, edhe vratë të-drejtinë; e ay nuk u rri juve kundrë.
- 7 Kini zëmërë të-gjerë pra, o vëllezër, gjer mbë t' ardhurit të Zotit. Na bujku tek pret të-paçëmuarënë pemë të dheut, e ka zëmërë

- të-gjerë për atë, gjersa të marrë shin' e-lash-8 të e të-voninë. Kini zëmërë të-gjerë edhe ju, forconi zëmëratë t' uaj; sepse t' ardhurit' e Zotit uafërua.
- 9 Mos psherëtini kundrë njëri tjetërit; o vëllezër, që të mos dënoneni; ja gjykatësi tek
- 10 rri përpara dyerve. Merrni për shëmbëllesë, o vëllezërit' e mi, të te-hequrit keq e të zëmërës' së-gjerë profitëritë, që folnë mb' emërit të
- 11 Zotit. Na tek lumërojmë ata që duronjënë; e keni dëgjuarë durimin' e Jovit, edhe e patë të-pastajmen' e Zotit, se Zoti është fort i përdëllyershim edhe i-dhëmçurë.
- 12 Edhe përpara të-gjithave, o vëllezërit' e mi, mos bëni be, as për qiellinë, as për dhenë, as ndonjë tjetërë be; po letë jetë poja juaj, po, edhe joja, jo; që të mos bini ndë dënim.
- 13 Heq keq ndonjë ndër ju? letë faletë; ka
- 14 zëmërë të-gëzuarë? letë psallnjë. Eshtë i-sëmurë ndonjë ndër ju? letë thërresë pleqt' e kishësë, edhe letë falenë përmbi atë, e let'a
- 15 lyenjënë më vaj mb' emërit të Zotit. Edhe urata që është me besë dot'a shpëtonjë atë që lëngon, edhe Zoti dot'a ngrerë atë; edhe ndë
- 16 pastëbërë faje, dot' i falenë. Rrëfëni fajetë njëri tjetërit, edhe fali njëri për tjetërinë, që të shërohi. Shumë fuqi ka të-luturit' e të-drejtit,
- 17 kur bënetë me të-nxehëtë. Ilia ishte një njeri që pësonte posi ne, edhe ufal dyke luturë që të mos bjerë shi; edhe nukë ra shi mbi

18 dhet tre vjet e gjashstë muaj; Edhe përsëri ufaj, edhe qiell dha shi, edhe dheu dha pemën' e ti.

19 O vëllezër, ndër daltë ndonjë ndër ju jashtë udhës' së të-vërtetësë, edhe t'a kthenjë ndonjë

20 atë, Let'a dijë se ay që kthen fajtuar prej kobimit të udhës' s' ati, dotë shpëtonjë një shpirt prej vdekjeje, edhe dotë mbulonjë shumicë fajesh.
